



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

---

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Nr. 001/18**

**Datë: 31.05.2010**

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës Nr.03/L-040, neni 18.1, paragrafi (e), Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17, neni 6, neni 7, si dhe Statutit të Komunës së Junikut neni 20.1 paragrafi (d), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur 31.05.2010 bie këtë :

**V E N D I M**

(Mbi themelimin e Qendrës për punë Sociale)

**Neni 1**

Me këtë Vendim Komuna themelon Qendrën për punë Sociale në Komunën e Junikut.

**Neni 2**

Qendra për punë sociale Selinë do ta ketë në Junik Rruga Regjionale Junik-Voksh-Deçan respektivisht në dalje të fshatit Junik.

**Neni 3**

Qendra për punë sociale në Junik do të ofroi të gjitha shërbimet e mirëqenies sociale të cilat janë të parapara me ligjin për shërbimet sociale dhe familjare si dhe me aktet e tjera nënligjore të lëshuara nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që rregullojnë fushën e shërbimeve në fjalë.

**Neni 4**

Struktura organizative e Qendrës për punë Sociale dhe sistematizimi i personelit do të jetë pjesë perberese e strukturës organizative të Komunës së Junikut, kjo qendër do të jetë pjesë vartëse e drejtorisë Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e aprovimit dhe dërgimi në Zyrën ligjore të MAPL-së.

**Me këtë vendim të njoftohet:**

- Kryetari i Komunës
- Drejtori i DSHMS-së
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Arkiva e Komunës-Junik.

Kryesuesi i Kuvendit  
z.Sinan Gacaferi

---